Koha e lirë e fëmijës tënd është e rëndësishme

INFORMACION PËR AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË KOHËS SË LIRË

Skolverket
Swedish National Agency for Education

PAULINE ST-DENIS/FANCY

Institucioni i kohës së lirë është për fëmijën tënd

Ti si prind je ai që i qëndron më së afërmi fëmijës tënd. Për këtë arsye është me rëndësi që t`i tregosh personelit dhe rektorit të institucionit të kohës së lirë se çka mendon ti për shembull për aktivitetet, madhësinë e grupit, përbërjen dhe mënyrën se si pranohet fëmija yt. Nëse personeli dhe rektori dinë se çka mendon ti, atëherë është shumë me leht për ata që fëmijës tënd t'i ofrojnë atë që i nevojitet.

Që të mund të marrësh pjesë dhe të ndikosh, duhet që ti të jesh në dijeni për mënyrën se si është menduar të funksionojë institucioni i kohës së lirë.

Çfarë e drejton institucionin e kohës së lirë?

Institucioni i kohës së lirë drejtohet nga ligji i arsimit. Aty shkruan se grupi i fëmijëve do ta ketë një përbërje dhe madhësi të përshtashme, se lokalet duhet të jenë të përshtatshme, domethënë se do t'i përshtaten grupit të fëmijëve dhe aktivitetit specifik të veprimtarisë së institucionit të kohës së lirë, dhe se aktiviteti niset nga secila nevojë e fëmijës. Personeli do të ketë asi shkollimi ose aso përvoje që të mund t'i plotësojë nevojat e përkujdesjes dhe të aktivitetit pedagogjik për fëmijën tënd.

Institucioni i kohës së lirë po ashtu do ta zbatojë planin mësimor të caktuar nga qeveria. Ky është plani i njëjtë mësimor që vlen për klasën e parashkollores dhe për shkollën e obliguar. Aty shkruan për vlerat e përbashkëta të shoqësisë sonë dhe se cilat janë qëllimet dhe detyrat e shkollës dhe të intitucionit të kohës së lirë. Duke e lexuar planin mësimor, do të mësosh se çfarë parashikimsh dhe kërkesash mund të kesh si prind.

Komunat e Suedisë janë të detyruara që të ofrojnë institucione të kohës së lirë për fëmjët që janë në shkollë deri në moshën 12 vjeçare. Për fëmijët e moshave 10-12 vjeçare mund të ofrohet një qendër e hapur aktiviteteve të kohës së lirë ku fëmijët nuk janë të regjistruar. Qendra e hapur e aktiviteteve të kohës së lirë bazohet në vullnetarizëm dhe është një alternativë për fëmijët që nuk kanë nevojë për përkujdesjen dhe mbikëqyrjen e cila jepet në institucionin e kohës së lirë.

Autoriteti përgjegjës (komuna, ose nëse bëhet fjalë për ndonjë institucion privat, pronari i tij) mbajnë përgjegjësi që veprimtaritë e institucionit të kohës së lirë të planifikohen, të mbikëqyren dhe të vlerësohen nga personeli. Kontaktoni institucionin e kohës së lirë që të kuptoni se në çfarë mënyre ti dhe fëmija yt mund të merrni pjesë në vlerësim.

SUSANNE KRONHOLM/ETSA

MASKOT/MARTIN BOTVIDSSON

Koha e lirë dhe mbështetja kuptimplote në zhvillimin e fëmijës

Institucioni i kohës së lirë konform ligjit për arsimin do t`i ofrojë fëmijës një kohë të lirë dhe mbështetje kuptimplotë në zhvillimit. Që ata ta kenë këtë, ambienti duhet të jetë i sigurt, argëtues dhe stimulues. Lojërat, krijimet dhe aktivitetet fizike duhet të kenë hapsira të mëdha. I tërë aktiviteti do të formohet në bazë të moshës, pjekurisë, nevojave, interesimeve dhe përvojave të fëmijëve. Veprimtaria mund të ndryshojë varësisht nga ajo se cilët fëmijë marrin pjesë në te.

Institucioni i kohës së lirë luan një rol të rëndësishëm për aftësitë e të mësuarit të fëmijës, pasi që fëmija mëson në lidhje logjike gjatë tërë ditës. Është detyrë e personelit që ta unifikojë përkujdesjen dhe të mësuarit. Ata, për shembull, do ta ndihmojnë fëmijën tënd të mësojë se si të sillet në mënyrë shoqërore dhe të bëhet i pavarur, t`i respektojë dallimet dhe botëkuptimet e ndryshme si dhe të kuptojë se ndonjëherë duhet të bëjë kompromis.

Një plotësim për shkollën

Personeli i shkollës dhe i institucionit të kohës së lirë bashkëpunon shpesh për së afërmi dhe në këtë mënyrë fëmija yt ka mundësi që gjatë tërë ditës të zhvillojë dituri dhe kompetenca të ndryshme. Institucioni i kohës së lirë, sikur edhe shkolla, është një veprimtari grupore pedagogjike, e cila duhet të jetë argëtuese dhe stimuluese për fëmijën tënd dhe duhet poashtu edhe ta ruaj interesimin dhe dëshirës e fëmijës tënd për të mësuar.

Institucioni i kohës së lirë e plotëson shkollën në dy mënyra:

NË ASPEKTIN KOHOR, duke i pranuar fëmijët gjatë asaj pjese të ditës kur ata nuk janë në shkollë dhe gjatë pushimeve. Kjo do të jetë e atillë që ti si prind do të keshë mundësi të punosh ose të studiosh.

NË ASPEKTIN E PËRMBAJTJES duke iu dhënë fëmijëve në njëfarë mënyre përvoja dhe dituri të tjera nga ato të cilat ata i marrin në shkollë.

CORBIS

Pjesëmarrja dhe ndikimi i fëmijës

Fëmija yt ka të drejtë ta shprehë mendimin për veprimtarinë e institucionit të kohës së lirë. Duke iu dhënë mundësia që në mënyra të ndryshme t`i shprehë mendimet dhe botëkuptimet e veta, fëmija mund të mësojë se si funskionon demokracia. Është mirë që fëmijëve t`u lejohet të marrin pjesë gjatë planifikimeve dhe, për shembull, gjatë mbledhjeve dhe vlerësimeve të thonë se çka mendojnë. Me kënaqësi bisedo me personelin në lidhje me këtë dhe inkurajo fëmijën tënd që t`i formulojë botëkuptimet dhe mendimet e veta.

Ti mund të ndikosh

Një bashkëpunim i afërt mes personelit dhe prindërve është shumë i rëndësishëm me qëllim që fëmija yt të ndjehet i sigurt në institucionin e kohës së lirë. Në planin mësimor shkruan se të gjithë ata që punojnë në shkollë dhe në institucionin e kohës së lirë duhet të bashkëpunojnë me prindërit me qëllim që bashkërisht ta zhvillojnë veprimtarinë. Ti, për shembull, mund të flasësh me personelin gjatë kohës kur e merr ose e lë fëmijën, në mbledhjet me prindër ose gjatë bisedave konsultative.

Nëse ti ke ndonjë këndvështrim në lidhje me cilësinë e veprimtarisë, ti gjithashtu mund t'i drejtohesh komunës ose drejtorisë përgjegjëse.

ROY MCMAHON/CORBIS

Nëse ti dëshiron të dish më shumë për atë se çka e drejton cilësinë e institucionit të kohës së lirë, atëherë mund t`i lexosh Këshillat e përgjithshme të Enti Kombëtar për Arsim dhe komentet për cilësinë e institucioneve të kohës së lirë. Ato gjenden në të gjitha institucionet kohës së lirë. Ti edhe mund ta porositësh kopjen për vete nga Qendra e Shërbimit të Fritzes ose ta shkarkosh nga faqja e internetit e Entit Kombëtar për Arsim www.skolverket.se

Fotografia në kopertinë: Kenneeth Hellman/Etsa
Forma grafike: AB Typoform

Skolverket

www.skolverket.se